



## Sigurimet tradicionale bujqësore

Doracak për vlerësimin e dëmeve nga breshëri tek vreshtat me rrush të verës

Projekti për Financimin e Bujqësisë për Evropë dhe Azi Qëndrore

IN COOPERATION WITH:



**WORLD BANK GROUP**  
**IFC** International Finance Corporation

## Tabela e Përmbajtjes

<b>1. Qëllimi i doracakut/ udhëzuesit të vlerësimit të dëmeve</b> .....	<b>3</b>
<b>2. Objektivat e Doracakut së Metodologjisë së Vlerësimit të Dëmeve</b> .....	<b>3</b>
<b>3. Sigurimi Bujqësor – Kufijtë e dëmshpërbimit/ Kostoja e prodhimit</b> .....	<b>3</b>
<b>4. Përshkrimi i vreshtave me rrush për verë</b> .....	<b>3</b>
4.1. Tipet e prodhimit .....	3
4.2. Mosha e vreshtave me rrush të verës .....	4
4.3. Varietetet e rrushit të verës .....	4
<b>5. Rreziqet në bujqësi</b> .....	<b>4</b>
5.1. Rreziqet e siguruara .....	4
5.1.1. Breshëri - definimi i rrezikut .....	4
5.2. Definimi i Rrezikut tek sëmundjet e rrushit të verës .....	5
5.3. Rreziqet e pasiguruara.....	5
<b>6. Procedurat e vlerësimit të dëmit</b> .....	<b>7</b>
6.1. Njoftimi i ngjarjes .....	7
6.2. Hapat e vlerësimit të dëmeve dhe procedurat.....	7
6.3. Dokumentet e nevojshme për procesin e vlerësimit të dëmeve në terren.....	8
6.4. Pajisjet e nevojshme për procesin e vlerësimit të dëmeve .....	8
6.5. Prezentimi i vlerësuesit të dëmeve.....	10
6.6. Konfirmimi i koordinatave të GPS-it dhe Vendosja e Koordinatave .....	10
6.7. Procesi i identifikimit të dëmit.....	10
6.8. Veprimet e Vlerësuesit të dëmeve gjatë vizitës në terren .....	11
6.9. Numri i mostrave për qëllime të vlerësimit të dëmeve .....	11
<b>7. Metodologjia e vlerësimit të dëmeve para-vjeljes</b> .....	<b>12</b>
7.1. Fotografitë e kërkueshme nga vlerësuesi i dëmeve .....	13
<b>8. Përfundimi i procesit për vlerësimin e dëmit</b> .....	<b>15</b>
8.1. Kalkulimi i dëmeve/ Rezultatet e vlerësimit të dëmeve.....	15
<b>Shtojca 1. Formulari i njoftimit të dëmit</b> .....	<b>16</b>
<b>Shtojca 2. Formulari i Ngastrës</b> .....	<b>17</b>
<b>Shtojca 3. Raporti i inspektimit të vlerësimit të dëmeve</b> .....	<b>18</b>
<b>Shtojca 4. Raporti i kalkulimit të dëmshpërblimit</b> .....	<b>19</b>

## 1. Qëllimi i doracakut/ udhëzuesit të vlerësimit të dëmeve

Ky dokument përcakton rregullat dhe procedurat, të cilat duhet të respektohen nga një vlerësues i dëmeve gjatë kryerjes së një vlerësimi të dëmeve (humbjeve) në vreshtat e siguruara me sigurim bujqësor. Dokumenti përshkruan metodat për përcaktimin e dëmeve, llogaritjet, afatet kohore, dhe dokumentet e nevojshme.

Doracak i vlerësimit të dëmeve do të ndihmojë vlerësuesit e dëmeve për përcaktimin e dëmeve në sigurimet bujqësore tradicionale për prodhuesit e rrushit. Mbulimi me sigurim do të fillojë nga shfaqja e fazës së formimit të frutave deri në periudhën e vjeljes.

Rekomandimet metodologjike janë zhvilluar për programin e sigurimit bujqësor të ashtuquajtur një rrezik (breshër) për vreshtat me rrush vere për periudhën e ciklit të frutifikimit. Në këtë program mund të sigurohen vetëm vreshtat e kombinuara të rrushit të verës. Dokumenti nuk jep rekomandime lidhur me vlerësimin e dëmeve për vreshtat me rrush të tryezës.

## 2. Objektivat e Doracakut së Metodologjisë së Vlerësimit të Dëmeve

Qëllimi i këtij doracak është që të udhëzojë ekspertët (vlerësuesit e ardhshëm të dëmeve) të cilët do të merren me vlerësimin e dëmeve për rrushin e verës. Përshkruan procedurat që duhen ndjekur për vlerësimin e dëmeve. Ky doracak shërben vetëm për sigurimet tradicionale të rrushit të verës. Ky udhëzues gjithashtu do të ndihmojë ekspertët të kenë qasje të njëtrajtshme gjatë procedurave të vlerësimit si dhe renditjen e plotësimin të dokumenteve. Kjo do të mundësojë një transparencë më të madhe, e cila do të rrisë kredibilitetin për fermerët dhe kompanitë e sigurimeve, pas vlerësimit të dëmeve në vreshta të prekura nga breshëri.

## 3. Sigurimi Bujqësor – Kufijtë e dëmshpërbimit/ Kostoja e prodhimit

Për qëllime të sigurimit tradicional, kufiri i dëmshpërbimit do të jetë kufiri i kostos së prodhimit për vreshta të kombinuara të rrushit të verës. Kufiri i kostos së prodhimit për vreshta të rrushit të verës me teknologji të kombinuar të prodhimit për 1 hektarë është llogaritur në shumën prej 1,800 euro. Të gjitha pagesat e dëmshpërbimit për polisat e sigurimit të vreshtave të rrushit të verës do të bazohen në këtë shumë të siguruar.

## 4. Përshkrimi i vreshtave me rrush për verë

### 4.1. Tipet e prodhimit

Për qëllime të sigurimit tradicional, do të konsiderohen vetëm vreshtat me teknologji të kombinuar të prodhimit. Karakteristikat e prodhimit të vreshtave me teknologjisë të kombinuar janë si mëposhtë:

Rrushi i verës mbillet në një strukturë të dendur në një distancë mes rreshtash prej prej 2.5 m dhe në një distancë të trupave (hardhive) brenda rreshtit prej 1 m. Në një sipërfaqe prej një hektarë (1ha), një vreshtë e tillë, ka të paktën 4.000 fidane/trupa të mbjellura, si parakusht për marrjen e rendimentit të lartë dhe të qëndrueshëm. Vreshtat me teknologji të kombinuar nuk përfshijnë sistemin e ujitjes dhe fidanet amerikane.

## 4.2. Mosha e vreshtave me rrush të verës

Vreshtat e pranueshme për sigurim bujqësor tradicional të rrushit të verës do të jenë vreshtat nga mosha 3 deri në 30 vjeçe. Vreshtat e kësaj kategorie të moshës konsiderohen si më produktive dhe më fitimprurëse për fermerët. Në vitin e parë (viti 1) nuk ka prodhim. Në vitin e dytë (viti 2) aktivizohet pothuajse 50% e prodhimit të rrushit dhe në vitin e tretë (viti 3), arrihet prodhimi i plotë.; Një hardhi e rrushit mund të prodhojë të paktën 6 kg ose rreth 20-25 kalaveshë të rrushit. Për një sipërfaqe prej një hektarë (1 ha), prodhimi mund të kap peshën afër merit 8 - 12 MT / ha. Pas vitit të tridhjetë (viti i 30-të), vreshtat nuk janë më produktive dhe fitimprurëse.

## 4.3. Varietetet e rrushit të verës

Polisa për sigurimin e vreshtave me rrush të verës do të mbulojë dëmt për të gjitha varietetet e rrushit të verës që kultivohen në territorin e Republikës së Kosovës. Këto varietete duhet poashtu të jenë të regjistruara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Disa nga varietetet më të përhapura të rrushit të verës në Kosovë janë: Vranac, Cabernet, Smederevka, Pinot, Game, Burgundi i Zi, Shardone, Rizling Rajne, Shiraz, dhe Sheshi i Zi. Rrushi i verës është i dedikuar për përpunuesit lokal të rrushit ku shumica prej tyre ndodhen në komunën e Rahovecit.

## 5. Rreziqet në bujqësi

### 5.1. Rreziqet e siguruar

#### 5.1.1. Breshëri - definimi i rrezikut

Breshëri është një fenomen i zakonshëm meteorologjik, i cili është vazhdimisht i pranishëm me frekuencë dhe ashpërsi të lartë. Zakonisht ndodh gjatë "**muajve të ngrohtë të vitit**", duke filluar nga muaji Maj deri në Gusht. Frekuenca më e madhe e breshërit ndodh gjatë muajit Maj dhe Qershor, por në një kuptim më të gjerë mund të ndodhë edhe më herët, si fundi i prillit deri në fund të shtatorit. Zakonisht shfaqet në orët e pasdites, diku rreth orës 13:00. deri në orën 20:00. dhe zgjat maksimalisht 10 minuta. Zonat e prekura më shpesh nga breshëri duket të jenë të ngushta në formë të shiritave.

Zakonisht në praktikë, detyrimet e siguresit për pagesat e dëmshpërblimit fillojnë kur 50% e petaleve bien nga lulet e të njëjtit varietet dhe nëse kalaveshët e pjekur nuk vjelen brenda 10 ditëve pas përfundimit të periudhës së vjeljes apo 30 shtatorit, përmbledhur me muaj nga 15 Maj deri me 30 Shtator. Breshëri mund të dëmtojë frutat, gjethet dhe lëvoret e kokrrave të rrushit, megjithatë sigurimi zakonisht mbulon vetëm kalaveshët e dëmtuar në vitin aktual.

Pas shfaqjes së breshërit, kalaveshët e rrushit të verës do të dëmtohen. Kur breshëri sulmon kokrrat e kalaveshit, rezultatet mund të jenë shkatërruese në skenarët e mëposhtëm për periudha të ndryshme:

- 1) Nëse ndodh breshër gjatë fazave të hershme të zhvillimit të hardhisë, mund të shkaktojë dhëmbëza ose dëm kokrrash. Nëse ndodh kur rrushi është me madhësi bizelesh, atëherë kokrrat e dëmtuara të rrushit do të thahen dhe do të bien. Vreshtat do të vazhdojnë të prodhojnë rrush të mjaftueshëm për prodhuesit e verës për të rimarrë prodhimin e tyre.

- 2) Nëse shfaqet breshëri gjatë periudhës së pjekjes ose pas kësaj periudhe, atëherë ndodh ndryshimi i ngjyrës së kokrave të rrushit. “*Veraison*” paraqet periudhën e fillimit të pjekjes, përkatësisht periudhën e tranzicionit nga rritja e kokrave të rrushit deri në pjekjen e tyre. Shumë ndryshime mund të shfaqen gjatë kësaj periudhe të cilat qojnë në copëtimin e kokrave të frutit. Sidoqoftë, nëse breshëri godet rrushin e verës më vonë gjatë sezonit, atëherë hardhia ka më pak gjasa për përmirësim - "kjo do të thotë se prodhimtaria do të jetë më e vogël ose fare prodhim. Pas breshërit në kohën e fillimit të pjekjes së rrushit, është e mundur të përdoren vetëm produkte kimike për mbrojtjen e bimëve që nuk dëmtojnë shëndetin e njeriut ose nuk shkaktojnë pasoja negative në procesin e vilifikimit.

## 5.2. Definimi i Rrezikut tek sëmundjet e rrushit të verës

Sëmundja e njohur si Kalbëzimi (Botritisi) shfaqet gjatë motit të lagësht, sidomos pas breshërit, të shkakuar nga kërpudha nekrotrofike “*Botrytis Cinerea*” që shfaqet në vreshta menjëherë pas stuhisë së breshërit. Kokrrat e rrushit janë veçanërisht të ndjeshme ndaj kësaj sëmundjeje. Në shumicën e rasteve kur breshëri godet vreshtin, sëmundja më e zakonshme që shfaqet në kokrrat e rrushit është kalbëzimi, sepse konsiderohet se sasia e lagështisë është shumë e lartë dhe pasiqë kokrrat e rrushit janë të dëmtuara nga breshëri, janë edhe më shumë të ekspozuara ndaj kësaj sëmundjeje. Fotografitë e mëposhtme tregojnë shenjat kryesore të kësaj sëmundjeje:



*Dëmtimi i vreshtit nga breshëri*



*Kalbëzimi i kokrave të rrushit*

## 5.3. Rreziqet e pasiguruara

Rreziqet e pasiguruara që nuk mbulohen nga polisat e sigurimit të rrushit të verës janë: sëmundjet e tjera (pluhuri, hiri i rrushit), erërat, dëmtuesit (Filoksera, Lobesia, merimangat), barojat e këqija (bari veror) Këto rreziqe duhet të menaxhohen nëse fermeri do të zbatojë praktikën e mirë bujqësore (GAP).

*Vrugu i Rrushit*



*Hiri i Rrushit*



*Filoksera*



*Lobesia (Insekt)*



## Barojat



## 6. Procedurat e vlerësimit të dëmit

### 6.1. Njoftimi i ngjarjes

Pas shfaqjes së breshërit, veprimet dhe afatet e mëposhtme duhet të respektohen:

1. Fermeri është i detyruar të njoftojë dëmin **me shkrim** brenda 48 orëve nga data e paraqitjes, duke plotësuar formularin e njoftimit të dëmit, ta nënshkruajë dhe ta dërgojë tek Kompania e Sigurimeve, përmes postës elektronike ose ta dorëzojë në zyrën më të afërt të Kompanisë së Sigurimeve.

Forma e njoftimit të dëmit do të sigurohet nga Kompania e Sigurimeve gjatë procesit të sigurimit dhe do të publikohet në faqen e internetit të Siguruesve dhe Ministrisë së Bujqësisë, por gjithashtu do të jetë në dispozicion sipas kërkesës së fermerit në çdo kohë. **Formulari i Njoftimit të Dëmeve bujqësore mund të gjendet në Shtojcën 1, në fund të këtij doracak.**

2. Formulari i Njoftimit të Dëmeve bujqësore duhet të jetë me datë të saktë dhe të nënshkruhet nga fermeri apo personi i autorizuar.

### 6.2. Hapat e vlerësimit të dëmeve dhe procedurat

Kompania e Sigurimeve do të shqyrtojë formularin e njoftimit të paraqitur nga fermeri dhe do të kontrollojë nëse polisa është e pranueshme për dëmshpërblim.

Pasi kompania e sigurimit konfirmon vlefshmërinë dhe mbulesën e polisës së sigurimit, kërkesa duhet të regjistrohet dhe të miratohet për vlerësimin e dëmeve. Në këtë fazë, Kompania e Sigurimeve duhet të caktojë një vlerësues të dëmeve për të kryer procesin e vlerësimit të dëmeve për këtë kërkesë të veçantë përpara periudhës së vjeljes. Vlerësuesi i dëmeve duhet të zgjidhet nga lista e vlerësuesve të certifikuar dhe të autorizuar brenda MBPZHR-së. Pas ndodhjes së dëmit, hapat e mëposhtëm duhet të ndjeken:

1. Fermeri dorëzon kërkesen për njoftim të dëmit tek Kompania e Sigurimit;
2. Kompania e Sigurimit shqyrton kërkesen dhe cakton një vlerësues të dëmit;
3. Vlerësuesi i dëmeve duhet të mbledhë të gjithë informacionin dhe dokumentet e nevojshme nga Siguruesi para vlerësimit të dëmit siç përshkruhet në pikën 6.3;

4. Vlerësuesi i dëmeve pasi të ketë marrë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm nga Kompania e Sigurimeve, do të llogarisë para-vlerësimin e dëmit përpara se të bëjë vlerësimin e dëmeve në terren. Para-vlerësimi i dëmeve do të bazohet në dokumentacionin e siguruar nga Kompania e Sigurimeve, por vlerësimi i vërtetë i dëmeve në terren do të bëhet 5-10 ditë para vjeljes.
5. Para kryerjes së vizitës në terren, vlerësuesi i dëmeve do të kontaktojë fermerin për të caktuar datën dhe vendin e saktë për vizitë në terren. Gjeoportali i mëposhtëm mund të jetë shumë i dobishëm për të përcaktuar vendndodhjen e saktë të vreshtave të dëmtuara: <http://geoportal.rks-gov.net/en/filimi>.
6. Pasi të jetë aranzhuar vizita, Vlersuesi i Dëmeve do të njoftojë Kompaninë e Sigurimeve, në mënyrë që ata të mund të ndjekin përmbushjen e aktiviteteve nga vlerësuesi i dëmeve.

### 6.3. Dokumentet e nevojshme për procesin e vlerësimit të dëmeve në terren

- Polisa e Sigurimit,
- ID-ja e fermerit,
- Certifikata Kadastrale dhe Kopja e Planit,
- Certifikata nga kadastri i vreshtave,
- Forma për njoftimin e dëmit,
- Formulari i planit të vreshtës-terrenit të mbjellur (kjo duhet të nënshkruhet nga të dyja palët),
- Raporti i inspektimit (kjo duhet të nënshkruhet nga të dy palët).

### 6.4. Pajisjet e nevojshme për procesin e vlerësimit të dëmeve

Për përfundimin me sukses të punës, procesi i vlerësimit të dëmeve duhet të shoqërohet me pajisjet (mjetet) e mëposhtme):

- Marrësi GPS ose pajisje të tjera me softuer të përshtatshëm; GPS është sistemi kompleks elektronik-teknik i përbërë nga një grup i pajisjeve tokësore dhe hapësinore të përdorura për të përcaktuar koordinatat gjeografike (gjatësia, gjerësia dhe lartësia mbi nivelin e detit). GPS navigator përdoret për fiksimin e koordinatave të fushave të ekzaminuara. Kompjuteri i dorës me GPS-marrës, nëse instalohet softueri i duhur, lejon jo vetëm rregullimin e koordinatave gjeografike, por edhe llogaritjen e zonës së matur.





- Kamera me aftësinë për të shfaqur datën e marrjes së fotografive (dhe koordinatat GPS) me një rezolucion prej të paktën 10 megapiksel ose;
- Kamera, GPS dhe llogaritësi mund të kombinohen në një pajisje;



- Një tabletë, një fletë kartoni të bardhë, një fletore dhe një laps për regjistrimet dhe shenjat në terren;



- Gërshërë për krasitje



- Një kalkulator



## 6.5. Prezentimi i vlerësuesit të dëmeve

Pas mbërritjes në vendndodhjen e dakorduar, vlerësuesi i dëmit duhet të paraqesë kredencialet dhe autorizimin nga Kompania e Sigurimeve për të kryer inspektimin. Vlerësuesi i dëmeve do të informojë fermerin për vizitën, çfarë do të bëhet gjatë procesit të vlerësimit të dëmeve dhe ta inkurajojë atë të marrë pjesë në çdo veprim për hir të transparencës. Përfshirja e fermerit është e detyrueshme që vlerësimi i dëmeve të bëhet siç duhet.

## 6.6. Konfirmimi i koordinatave të GPS-it dhe Vendosja e Koordinatave

Për të vendosur koordinatat GPS-it në mënyrë më efektive dhe më të saktë, kërkohet që vlerësuesi i dëmeve të hyjë në 20 m brenda vreshtës së dëmtuar. Nuk lejohet të vendosen koordinatat jashtë vreshtës (për shembull, në rrugën pranë vreshtës, në një parcelë të afërt apo në një parcelë afër që nuk i përket fermerit). **Ky hap është shumë i rëndësishëm që të kryhet si duhet.**

Fotografia e mëposhtme paraqet një mjet për matjen e koordinatave.



## 6.7. Procesi i identifikimit të dëmit

Vlerësuesi i dëmeve i shoqëruar dhe i mbështetur nga fermeri, do të fillojnë së bashku procesin e identifikimit të vreshtës së dëmtuar duke shënuar zonën e dëmtuar. Në këtë fazë, vlerësuesi i dëmeve është i detyruar të plotësojë me dorë Formularin e planit të parcelës. **Shtojca 2: Formulari i planit të parcelës.**

## 6.8. Veprimet e Vlerësuesit të dëmeve gjatë vizitës në terren

Vlerësuesi i dëmeve duhet të shqyrtojë hartat e fushave dhe të përcaktojë rrugën optimale për lëvizjet e tij. Kjo procedurë do të lejonte shqyrtimin e të gjitha pjesëve të dëmtuara për përcaktimin e dëmeve brenda periudhës më të shkurtër. Rekomandohet të merrni fotografi gjatë vlerësimit të dëmeve duke treguar përfshirjen e fermerit dhe vlerësuesit të dëmeve.




*Vlerësuesi i Dëmeve*



*Vlerësuesi i Dëmeve dhe Fermeri*


## 6.9. Numri i mostrave për qëllime të vlerësimit të dëmeve

Për një vreshtë të dëmtuar të madhësisë 1 ose më pak se një hektarë ( $1 < 1$ ), numri i rekomanduar i mostrave duhet të jetë 5 dhe ato duhet të përzgjidhen sipas metodës së “zarfit të mbyllur”, sic tregohet në figurën mëposhtë:



*Metoda e zarfit të mbyllur*

Nëse zona e dëmtuar tejkalon një hektarë (1 ha), atëherë rekomandohet të përzgjidhni një mostër më shumë për çdo hektarë shtesë. Nëse forma e pemishtës është e rregullt përsëri, duhet të përdoret metoda e zarfës së mbyllur për përzgjedhjen e mostrës, por nëse forma e pemishtës është e parregullt atëherë mostrat duhet të zgjidhen bazuar në metodën “Zigzag”, e ilustruar në figurën mëposhtë:



Ju lutem referojuni tabelës së mëposhtme për numrin e saktë të mostrave për madhësi të ndryshme të vreshtave:

**Tabela 1. Numri i mostrave për ha:**

Sipërfaqja e vreshtit (ha)	Numri minimal i mostrave të kërkuara
0.5 hektarë ose ma pak	5
1 hektarë	6
1.5 hektarë	7
2 hektarë	8
3 hektarë	10
Cdo + 0.5 hektarë	+ 1 mostër shtesë

## 7. Metodologjia e vlerësimit të dëmeve para-vjeljes

Metodologjia e para-vjeljes aplikohet për vlerësimin e dëmeve në fazën e para-pjekurisë, dhe para se të vjelen frutat. Vlerësimi i dëmeve duhet të bëhet 5-10 ditë para periudhës së vjeljes, në varësi të kushteve klimatike dhe varieteteve.

Vlerësuesi i dëmeve dhe fermeri përcaktojnë pikat e marrjes së mostrave nga të cilat marrin kalaveshët e rrushit. Për shembull, për një vreshtë prej 0.5 ha, është përcaktuar të merren 5 pika mostrash sipas parimit "Zarf i mbyllur" nga i cili do të merren kalaveshët. Vlerësuesi i dëmeve dhe

fermeri hyjnë brenda në vreshtë dhe gjejnë një mostër midis 2 rreshtave të rrushit të verës. Fillimisht fillojnë të korrin 5 kalaveshë në një rresht anë të rrushit të rrushit të verës nga një hardhi rrushi, dhe llogarisin në secilën kalaveshë kokrrat e dëmtuara dhe të padëmtuara, pastaj vazhdojnë të vjelin 5 kalaveshë të tjerë në anën e kundërt të rreshtit të rrushit, në një tjetër hardhi rrushi dhe numërojnë numrin e kokrrave të dëmtuara dhe të padëmtuara gjithashtu për secilën kalavesh.

Në këtë mënyrë, vlerësuesi i dëmeve gjen përqindjen (në vijim %) e dëmeve për secilën kalavesh dhe më pas gjen % e dëmeve për secilën hardhi (mostër) (pikë mostër) dhe në fund gjen % e dëmeve për të gjithë zonën e dëmtuar të siguruar.

Përqindja e dëmeve për secilën kalavesh brenda një mostre (hardhie) duhet të identifikohet bazuar në metodën e numërimit të numrit total të kokrrave dhe kokrrave të dëmtuara/ padëmtuara dhe ky numër duhet të shkruhet në fletore ose letër bosh. Pas kësaj, përqindja e secilës mostër duhet të shkruhet në Raportin / kolonën e Formularit të Inspektimit që i referohet mostrave. Bazuar në këtë, të gjithë kalaveshët brenda një mostre duhet të llogariten, dhe të gjitha % e dëmeve për mostër duhet të raportohen.

Vlerësuesi i dëmeve dhe fermeri duhet të numërojnë të gjitha kokrrat për secilin kalavesh dhe pastaj të ndajnë kokrrat e dëmtuara nga ato të padëmtuara, pastaj të përdorin formulën e mëposhtme, e cila llogarit % e dëmeve në kalavesh. Ata duhet të numërojnë të gjitha kalaveshët në këtë mënyrë:

**Numri i përgjithshëm i kokrrave të dëmtuara / numri i përgjithshëm i të gjitha kokrrave x 100 =% e humbjes për kalavesh.**

Atëherë përqindjet (%) e të gjitha kalaveshëve duhet të mblidhen dhe ndahen me numrin e përgjithshëm të kalaveshëve për të gjetur mesataren e % së dëmeve për tërë mostrën (vreshtën e dëmtuar). Kjo mund të llogaritet me formulën e mëposhtme:

**Shuma e % e dëmeve e të gjithë kalaveshëve/ numri i përgjithshëm i kalaveshëve = % e humbjes për tërë mostrën**

Në përfundim të procesit të vlerësimit të dëmeve, rezultatet e inspektimit plotësohen në raportin i cili duhet të nënshkruhet nga të dy palët - vlerësuesi i dëmeve dhe fermeri. Dokumenti duhet t'i bashkangjitet raportit të inspektimit për nevojat e gjurmueshmërisë.

### 7.1. Fotografitë e kërkueshme nga vlerësuesi i dëmeve

Gjatë procesit të vlerësimit të dëmeve, duhet të shkrepën numër i mjaftueshëm fotografish nga pika dhe distanca të ndryshme, në mënyrë që të tregohet sa më saktë situata reale në vreshtë. Ju lutem shihni mëposhtë renditjen e fotografive që duhet të merren nga vlerësuesi i dëmeve gjatë inspektimit të vreshtës:

- Një pamje gjithëpërfshirëse që paraqet relievin e afërt:



- Një fotografi në mes të vreshtit që tregon rendet mes vreshtit:



- Fotografitë nga skaji i vreshtit nuk janë të pranueshme:



Për secilën fushë të dëmtuar të inspektuar, sëpaku tre fotografi nga të gjitha pozicionet duhet të shkrepën dhe ruhen në format elektronik dhe t'i paraqiten Kompanisë së Sigurimeve për regjistrimet e tyre.

## 8. Përfundimi i procesit për vlerësimin e dëmit

Pasi të përfundon procesi për vlerësimin e dëmit, vlerësuesi i dëmit duhet të plotësoj të gjitha dokumentat e nevojshme dhe t'i grumbullojë informatat të cilat do të dorëzohen në kompaninë e sigurimeve për pagesë të dëmshpërblimit. Aktivitetet si vijojnë duhet të mirren në konsideratë:

1. Të plotësohet formulari i parcelës së siguruar (Shtojca 2: Formulari i Ngastrës);
2. Të plotësohet raporti i inspektimit dhe të bashkangjitet letra e nënshkruar me kalkulimet (Shtojca 3: Raporti i Inspektimit. Inspektimit duhet të përmbajë kodin e fazës së vegjetacionit të hardhisë së rrushit).
3. Të plotësohet raporti mbi kalkulimin e dëmshpërblimit (Shtojca 4: Raporti i kalkulimit të dëmshpërblimit);
4. Të mblidhen dhe bashkangjiten fotografitë nga tereni;
5. Të dorëzohet i gjithë dokumentacioni tek Kompania e Sigurimit dhe të njoftohet fermeri paraprakisht.

### 8.1. Kalkulimi i dëmeve/ Rezultatet e vlerësimit të dëmeve

Llogaritja e dëmshpërblimit do të bëhet në bazë të Shtojcës 4: Raport mbi llogaritjen e dëmshpërblimit.

## Shtojca 1. Formulari i njoftimit të dëmit

### Formulari i Njoftimit të Dëmit

Emri i të sigurvearit: \_\_\_\_\_

Emri i kontaktit: \_\_\_\_\_

Adresa e të sigurvearit: \_\_\_\_\_

Shteti: \_\_\_\_\_ Qyteti: \_\_\_\_\_ Fshati: \_\_\_\_\_

Numri i telefoni: \_\_\_\_\_

Numri i Polisës: \_\_\_\_\_

Data efektive e polisës: \_\_\_\_\_

Tipi i Polisës: \_\_\_\_\_

#### Informacioni për kulturat e dëmtuara

Kultura:

Varieteti:

Data e vlerësimit të vjeljes

#### Informatat rreth Kulturës

Data e ngjarjes: \_\_\_\_\_

Adresa e ngjarjes: \_\_\_\_\_

Numri i ngastrave të dëmtuara \_\_\_\_\_ Sipërfaqja e dëmtura e ngastrës, ha

Lloji i ngjarjes:  Breshëri  Breshëri dhe Kalbëzimi

Përshkrimi i ngjarjes:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

#### Shtojca shitesë

Ju lutemi të merrni një kopje të secilës nga dokumentet e mëposhtme dhe ti bashkëngjisni ato në këtë formular:

1. Kopja e Polisës së Sigurimit
2. Letërnjoftimi
3. Me anë të kësaj konfirmoj që të gjitha informacionet e mësipërme janë të vërteta dhe korrekte në të mirë të njohurive dhe besimeve të mia.

4. Nënshkrimi: \_\_\_\_\_ Data dhe ora: \_\_\_\_\_



## Shtojca 2: Formulari i Ngastrës

<b>Forma e ngastrës</b>	
Nr _____	Data " ____ " _____ 20 ____
I siguruari/ Numri NIF _____	Kultura (emri) _____
Nr. Katastral _____	GPS koordinatat L _____ V _____
Sipërfaqja totale e ngastrës _____	Sipërfaqja e dwmtuar e ngastrës _____
<b>Vizuelizimi ngastrës</b>	
Veri	
Pwëndimi	Lindja
Jugu	
<b>Komentet e vlersuesit të humbjeve</b>	
<b>Nënshkrimet e anëtarëve të komisionit</b>	
I siguruari:	
Kompania e sigurimeve:	
Vlerwsuesi:	

### Shtojca 3 Raporti i inspektimit të vlerësimit të dëmeve

#### Raporti i inspektimit të vlerësimit të dëmeve

Informatat rreth kulturave të siguruara			№ _____			Informatat për të siguruarin		
Kultura			Kompania e Sigurimit			I siguruari/Numri NIF		
Sipërfaqja totale e siguruar/ Ha			№ i kontratës			Adresa		
Data e ngjarjes			Data e inspektimit			Numri i telefonit, e-mail		

**Pjesa 1**

**Informatat e dëmeve mbi të hyra**

Nr. Kadastral	Sip. HA	Sip. e dëmtuar/ Ha	GPS koordinatat në teren		Dëmet në secilën mostër %										Dëmet mesatare për ngastër %	
			N	E	5											
1	2	3			4	5	6	7	8	9	10	6				

**Pjesa 2**

**Komentet e ekspertit**

Nënshkrimi i të siguruarit	Përfaqësuesi i kompanisë së sigurimeve	Data e përpilimit të këtij raporti
Emri dhe Mbiemri i të siguruarit	Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit	Informatat kontaktuese të ekspertit
		Nënshkrimi i ekspertit

## Shtojca 4: Raporti i kalkulimit të dëmshpërblimit

### Raporti i kalkulimit të dëmshpërblimit

Informatat rreth kulturave të siguruara		№ _____		Informatat mbi të siguruarin	
Kultura		Kompania e Sigurimit		Emri i Fermerit	
Sipërfaqja totale e siguruar/Ha				Adresa	
№ i Raportit inspektues të vlerësimit të humbjeve		№ i Kontratës		Numri i telefonit, e-mail	

#### Pjesa 1

№ i ngastrës	Zona e dëmtuar (bazuar në LAIR), Ha	Kostoja e prodhimit, EUR per Ha	Kosto totale e prodhimit, EUR
1	2	3	4

#### Pjesa 2

Humbjet mesatare (bazuar në LAIR), %	Të zbritshme %	Të zbritshme, EUR (kol. 4 x kol.6)	Humbjet për ngastër, EUR (kol. 4 x kol. 5 - kol.7)
5	6	7	8
	10		
	10		
	10		
	10		
	10		
	10		
<b>Shuma e përgjithshme e humbjeve EUR (Shuma kol. 8)</b>			

#### Pjesa 3

##### Komentet nga eksperti

Përfaqësuesi i Kompanisë së sigurimeve

Data e përpilimit të raportit

Emri i plotë i përfaqësuesit

Informatat kontaktuese të ekspertit